



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit- Municipality of Elez Han



02Nr 7803 /2022
15.09.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 neni 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 neni 8, Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 neni 35, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm Komuna Hani i Elezit rishpallë:

K O N K U R S
(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: Komuna Hani Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për lëndën Gjuhë Gjermane

njësia/ sektori: SHFMU" Ilaz Thaçi" dhe shkollat tjera në Han të Elezit.

Numri i pozitave : Një (1) pozitë me afat të pacaktuar

Koeficienti/Grada: A-421/1

Orët e punës: 20 orë në javë

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
- Niveli master arsimor;(300 ECTS)
- Sistemi katër vjeçar
- Baçelor; (katërvjeçar 240 ECTS);

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit, të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/a jo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Dokumentet e nevojshme:

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jete kopje të vërtetuara te noteri .
- Certifikata që nuk jeni nën hetime nga gjykata .
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i, tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 14.10.2022 deri 28.10.2022 (16:00).

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>, të gjitha dokumentet siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati përmes aplikacionit vetëdeklaroi se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzohet çdo aplikacion i kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/hanielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

